



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 10161 /2022
Data: 14.12.2022

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e njëmbëdhjetë -XI- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 27.10.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Bajrush Laçi** (Shef i Zyrës Ligjore), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim), Përfaqësuesi i OSBS-së. Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plotësim ndryshimi i rregullores për Transportin Rrugorë në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit.
3. Kërkesa për rishqyrtim të rregullores për taksa komunale për vitin 2023.
4. Raporti i vlerësimit të përgjithshëm për prona rezidenciale Komuna Hani i Elezit.
5. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.
6. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pika e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Plotësim ndryshimi i rregullores për Transportin Rrugorë në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Arsim Dernjani thekson:- materialin e keni para vetës. Janë kaluar të gjitha procedurat për këtë plotësim ndryshim të kësaj rregullore.

Zaim Bela thekson:- a është në harmoni me ligjin ky plotësim ndryshim i kësaj rregullore

Sherif Berisha thekson:- të njëjtën pyetje kam sikur para folësi dhe pasi të miratohet kjo rregullore kërkoj që të zbatohet.

Arsim Dernjani thekson:- jemi konsultuar dhe besoj që është në rregull.

Mehmet Ballazhi thekson:- kjo rregullore ka qenë më herët dhe është një ndryshim i një pike që lejohet të punohet edhe pas pensionimit dhe kjo rregullohet përmes një vërtetimi të mjekut dhe nuk kemi dashur të jemi diskriminues dhe e kemi proceduar për plotësim ndryshim.

Hanumshahe Dibrani thekson:- a përfshihen edhe veteranët.

Mehmet Ballazhi thekson:- ligji e parasheh edhe për çështjen e veteranëve dhe rregulloret bazohen në ligje.

Refet Kalisi thekson:- materialin kam lexuar por edhe komunat e tjera e kishin një rregullore të tillë dhe e përgëzoj drejtorin që e ka marr këtë hap dhe do të votoj pro ndryshimeve.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLOTËSIM NDRYSHIMI I RREGULLORES PËR TRANSPORTIN RRUGORË NË TERRITOIRN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

3. Kërkesa për rishqyrtim të rregullores për taksa komunale për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Majlinda Kaloshi thekson:- rregullorja është miratuar në kuvendin e komunës me datë 29.09.2022 dhe është dërguar në Ministri. Nga Ministria përkatëse kemi pranuar shkresë që kjo rregullore duhet të plotësohet edhe me disa detaje të vogla. Me material i kemi përcjell të gjitha shkresat të cilat i kemi pranuar. Pas miratimit në kuvend do të bëhen plotësimet dhe do të përcillen për në Ministrinë përkatëse.

Hyriete Isufi thekson:- është mirë me një sqaruar më në detale për ndryshimet të cilat i ka kërkuar Ministria për me i ndryshuar.

Majlinda Kaloshi thekson:-Ministria përkatëse ka kërkuar që të harmonizohen taksat në bujqësi dhe të në drejtorin e arsimit sipas legjislacionit në fuqi.

Zaim Bela thekson:- janë edhe disa taksa që kanë qenë por asnjë herë nuk i kemi vjelë dhe bëhet fjalë për taksën për shfrytëzimin e kullosave në pronën publike. Ekzekutivi para se me i proceduar në kuvend është mirë me i shikuar edhe aspektin ligjorë në mënyrë që pasi t'i miratojmë mos të kemi probleme me çështje të ligjshmërisë.

Mehmet Ballazhi thekson:- rregullorja parashihet për të gjithë pavarësisht se a mund të shfrytëzohen apo jo dhe nëse ka kërkesë dikush ne duhet të kemi rregulloren por nuk mundemi me ja imponuar dikujt për me i shfrytëzuar ata kullosa.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA PËR RYSHQYRTIM TË RREGULLORES PËR TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 2023

4. Raporti i vlerësimit të përgjithshëm për prona rezidenciale Komuna Hani i Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- e keni materialin për raportin e përgjithshëm për pronat rezidenciale në komunën tonë. Departamenti i tatimit në pronë nga Ministria e Financave kanë qenë në inspektim në komunën tonë dhe ka nxjerr një raport . Ata kanë bërë një vlerësim të përgjithshëm të normave tatimore duke u bazuar në ligjin për tatimin në pronë e paluajtshme dhe në bazë të udhëzimit administrative për metodologjinë e vlerësimit për qëllimet tatimit në pronë.

Zaim Bela thekson:- kërkoj sqarim për vlerësimin e pronave rezidenciale se a janë shtëpia të banimit apo vetëm objekte.

Lindita Ballazhi thekson:- janë kategorizuar të gjitha zonat e qytezës dhe të gjitha i keni tek tabela në faqe numër tre që çdo zonë e ka një kod të vetin dhe te çdo kodë është e përshkruar se cila zonë e qytetit i bien . Ky vlerësim është bërë për pronat rezidenciale në të cilën bëjnë pjesë shtëpitë dhe objektet dhe çdo zonë i ka normat tatimore.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI I VLERËSIMIT TË PËRGJITHSHËM PËR PRONA REZIDENCIALE KOMUNA HANI I ELEZIT

5. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- është rregullorja e cila i parasheh kriteret për ndarje të subvencioneve dhe sipas vlerësimit të komisionit.

Sherif Berisha thekson:- a do të bëhet subvencionin për fermerët të cilët kanë mbjell grurë në këtë vit.

Mehmet Ballazhi thekson:-fermerët nuk mund të subvencionohen edhe prej qeverisë edhe prej komunës sepse rregullorja e parasheh mënyrën e subvencionimit.

Zaim Bela thekson:- grurë ka shumë pak të mbjell, mirëpo serra mbi katër ari janë dikur afër njëzetë dhe mirë që është ndihmuar në shumë prej 250 euro. Shoqata e bletarisë është subvencionuar por është mirë me i subvencionuar edhe bujqit për me mbjellë grurë më shumë . Në Han të Elezit ka një numër bajgi të madh të bletëve dhe si familje ndoshta ja kanë parë hajrin por nuk kanë treguar ndonjë rezultat të mirë. Për çështje të serrave a nuk ka qenë informimi i mira apo ndoshta nuk i kanë serrat për shkak se në informatë shënon se kanë aplikuar njëzet fermer për serra.

Mehmet Ballazhi thekson:- thirrjet kur bëhen për subvencione të gjithë njoftohen njësoj dhe ndoshta dikush nuk ka pasur interes me aplikuar dhe të gjithë ata të cilët kanë aplikuar kanë qenë përfitues të subvencioneve duke u bazuar në rregulloren për ndarjen e subvencioneve. Subvencionimin për shoqatën e bletarëve e kemi rritë nga 2000 € sa ka qenë në vitin e kaluar në këtë vit janë ndarë 5000 € për shoqatën e bletarëve.

Refet Kalisi thekson:- sa i përket çështjes së serrave është mirë me dal një komision në teren dhe me vërtetuar se a është ai numër të cilin e përmendi z. Zaim Bela. Nuk besoj se nuk kanë qenë të informuar por ndoshta dikush edhe e ka shitur.

Mehmet Ballazhi thekson:- kërkesë nuk kanë parashtruar për subvencione e që ndoshta arsyet mund të jenë të ndryshme

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

6. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Resul Suma thekson:- në muajin tetor është bërë shërbimi i mamografisë për 54 gra , a keni informata se sa gra kanë rezultuar me kancer të gjirit. Kërkoj sqarim për çështje të stomatologut se deri ku kanë mbërritur procedurat.

Zaim Bela thekson:- a është e përcaktuar moshja për çështje të vaksinimit sezonal. QKMF-ja në Han të Elezit sa vakcina i ka pranuar për gripin sezonal.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- sa i përket mamografive tre grave ju ka rekomanduar për ekzaminime të më tutjeshme. Për çështjen e stomatologut jemi në fazat përfundimtare sepse jemi duke pritur për kërrigën stomatologjike për të cilën jemi në procedura dhe marrëveshja ka mbetur me u nënshkruar me kompaninë "Sharrcem". Për vaksinim nga gripi sezonal janë të përcaktuara moshat mbi gjashtëdhjetë e pesë vjet dhe rastet të cilat janë me sëmundje kronike dhe nuk kam ndonjë shifër se sa pacientë janë vaksinuar deri më tani por ka interesim.

Sherif Berisha thekson:- në mungesë të mjekut familjarë shumë shërbime qytetarët qofshin shëndetësore apo administrative po i kryejnë në komunën e Kaçanikut. Te aktivitet në nivel të DSHMS-së është e vërtetë që AMF-në në fshatin Gorancë e keni rifunksionalizuar por vetëm me fotografi por në këto javë në faqe zyrtare të QKMF-së po i njoftoni qytetarët se AMF-ja është e mbyllur për shkak të trajnimit të stafit, për transparencë dhe korrektësi tash për mos punë në AMF në fshatin Gorancë në ditët e caktuara nga vetë ju i caktoni dhe i postoni në faqe të juaj. Nëse AMF-ja nuk punon për shkak të trajnimit të stafit është mirë të na i dëshmoni me agjendën e trajnimit apo ftesat e trajnimeve sepse në të kundërtën ky aktivitet i juaji mund të llogaritet i dështuar po vetëm në fotografi për shkak se nuk mund të quhet rifunksionalizim i AMF-së pa pasur prezencë të mjekut. Te projekti i ri i punimit të tavanit ju e dini që është prej buxhetit të viti të më hershëm por shpresoj që ta funksionalizoni projektin i cili është për nxemjen. Më intereson të dijë sa ju ka kushtuar asgjësimi i barnave dhe a jeni në dioni që një pjesë e barnave janë derdhur me urdhëresë të drejtoreshës së QKMF-së. Pagat jubilarë kanë qenë të planifikuara me ish buxhetin e planifikuar nga ish qeverisja dhe ju i keni paguar dhe nuk keni pse mburreni në këtë drejtim. Pse mjekë me marrëveshje të veçantë dhe pse vendi i

lirë i mjekut në listë të pagave tash e një vit, kërkoj sqarime se cilat janë planet e drejtorisë sa i përket stafit. Në takimin që keni pasur me shoqatën "Islamik Relief" çfarë përgjigje keni marr për kërkesat të cilat i keni parashtruar. Me kalimin e dokoreshës si ushtruese e detyrës në QKMF ju nuk po punoni me gjashtë mjek por me pesë mjek sepse i bien që QKMF-ja sipas këtij tabelori të cilin e keni paraqitur i paka shtatë mjekë. Numri i intervenimeve nga viti i kaluar qenka 3000 intervenime më pak dhe e njëjta situatë është edhe në sektorin e diagnostikës vërehet një rënie e shërbimeve prej 546 shërbime dhe është mirë me dhënë sqarim se pse ka rënë ki numër. Te emergjenca keni një diferencë të rënis diku 5000 shërbime më pakë më intereson të dijë pse është kjo rënie. Numri i kontrolleve për vitin 2021 është 18 645 ndërsa në vitin 2022 është 20 527 ndërsa keni një participim prej 5000 € më pakë. Nuk keni bërë një krahasim të derivateve përveç shumës që e keni paraqitur krahasime nuk keni bërë. Pyetjet që po i parashtroni përgjigjet po i marr vetëm unë si asamblistë dhe është mirë me u sqaruar se a duhet t'i pranojnë edhe asamblistët e tjerë.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- sa i përket shërbimeve që janë më pakë për shkak se vitin e kaluar ka qenë pandemia dhe duhet ta keni parasysh që rastet kanë qenë më të shumta dhe më emergjente. Në këtë vit kemi raste më pak gjendja është më stabile dhe duhet të mburremi që kemi raste më pak se gjendja e shëndetësore e qytetarëve tonë është më e mirë. Ndërsa për çështjet tjera të cilat i parashtroni këshilltari në fjalë do të jap sqarime me shkrim.

Mehmet Ballazhi thekson:- jeni në Han të Elezit dhe nuk mundet dikush prej tjetër kuhi me të shtijë për interesa politik dhe është mirë mos me lejuar vetën. Është kuvend që duhet të sqarohen gjërat për shkak se është për me sqaruar qytetarët dhe nëse e shihni që është informatë në shëndetësi drejtoresha e ka paraqitur gjendjen në shëndetësi, mirëpo nëse duhet një raport që na duhet me i bërë edhe krahasimet e derivateve që ne jemi duke i bërë pa kërkesën e askujt në mënyrë që me i parë se çfarë shpenzime janë por mundohuni me bërë pyetje për të na ndihmuar edhe neve që të jemi më efikas në punën tonë e nuk është mirë me bërë çështje politike që me potencuar që je më i zëshmi në kuvend sepse nuk të ndihmon as ty. Mundohu ty me bërë një pyetje që me të than potencoj pa telefon ata që pate me i potencuar dhe unë mendoj që nuk mundesh me i potencuar për shkak se na e njohim gjithë secilin. Ne jemi fitues të një çmimi të cilin e kanë vlerësuar ndërkombëtarët, Këshilli Evropian dhe të gjitha ata të cilat po i potencon ty i kanë vlerësuar ata dhe nuk janë ardhur me na pyetur neve por kanë bërë hulumtime veçmas duke filluar prej QKMF-së, në arsim, në administratë dhe në zhvillim të projekteve. Është mirë të mundoheni me qenë transparentë për zhvillimin e Hanit të Elezit për shkak se neve nuk na vihet me parë se si zhvillohet Prishtina prej ktuhit.

Sherif Berisha thekson:- unë u thirra në informatën për shëndetësi dhe të gjitha ata të cilat i potencova kanë qenë të adresuara prej drejtoreshës me pika të veçanta dhe ata të cilat i potencova u dakordua për me i dërguar me shkrim.

Nora Xhoni thekson:- fillimisht ju përgëzojë për çmimin për qeverisje të mirë por kam një pyetje për drejtoreshën që gjitha procedurat e analizave në QKMF zhvillohen mirë por vetëm një analizë e gjëndrave tiroide ishte problem dhe a është zgjidhur ky problem

Malik Berisha thekson:- në Ministri e pash njoftim për shtimin e stafit për vitin 2023 a keni ndonjë informacion për këtë çështje

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- aparatura për analizat e gjëndrave teroide vlere reale nuk është për shkak se po i tregon më të rritura. Procedurën e kemi zhvilluar dhe besoj që do të përfundojnë procedurat brenda javës. Stafi prej 300 mjekëve në Ministri të Shëndetësisë është parapri nga viti 2023 deri në vitin 2025 por fatkeqësisht Hani i Elezit nuk është përfshirë në vitin 2023. Takime ka pasur dhe kam kërkuar sqarim që pse nuk jemi përzgjedhur por nuk më kanë dhënë arsye.

Kryesuesi thekson:- familjet e dëshmorëve të cilët kanë pasur me shkuar në bajë a keni informacione se a kanë shkuar të gjithë apo sa prej tyre kanë shkuar.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- në bajë kanë shkuar pesë nëna të familjeve të dëshmorëve dhe disa prej tyre e kanë shfrytëzuar bajun para se me përfunduar procedurat.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- numrin e nxënësve për secilën shkollë veç e veç dhe krahasimin me vitin e kaluar dhe me këtë vit. Te hekurudha te Ura e Seçishtës me i shikuar mundësit që me u mbushur dy anët për shkak se është problem.

Refet Kalisi thekson:- çmimin të cilin e ka marr komuna a është marr vetëm për vitin 2022 apo ka pasur edhe vite të tjera . A është rregulluar agregati te çerdhja për shkak se tash është koha e ftohët. Deri ku kanë mbërri punimet për çështjen e ujit.

Hisni Luri thekson:- numri i nxënësve për çdo vit ka ndryshuar se 39 kemi qenë më pak se vitin e kaluar por do tu a jap saktë numri e nxënësve se i kërkoja prej drejtorëve. Sa i përket agregatit vazhdimisht kam kërkuar prej KEDS-it por besojmë se do ta kryejmë për shkak se kanë kërkuar që kabloja mos me hyjë nën tokë.

Arsim Dernjani thekson:- sa i përket pyetjes së z. Zaim Bela nuk mundemi me shtruar më shumë për shkak se nuk na lejohet prej hekurudhës sepse janë duke i kryer punimet. Sa i përket çështjes së ujit janë duke u zhvilluar punimet dhe tash janë duke filluar punimet për çështje të shtyllave elektrike dhe pasi të vendosen shtyllat elektrike janë edhe disa punime.

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket çmimit për qeverisje të mirë bëhet fjalë për vitin 2022 dhe është një motivim i mirë për komunën e Hanit të Elezit dhe këtë çmim ja dedikojë qytetarëve që kanë bashkëpunuar me neve, ja dedikojë institucioneve, shërbyesve civil, ekipit tim dhe do të thotë që të gjithë jemi meritore për këtë çmim sepse të gjithë po e bëjnë punën e vetë pra gjithë secili e ka meritën e vetë.

Hyriete Isufi thekson:- kërkoj informacion për çështjen e printerit te shkolla e mesme.

Resul Suma thekson:- Ministria e arsimit i ka shkëputur kontrata kolektive një anshmërishtë çdo të merrni ndonjë veprim si komunë përmes asociacionit të komunave. Qeveria donë me bërë me ligj që të hyrat vetanake të cilat nuk shpenzohen me u kthyer në Qeveri e jo me u kthyer në komunë siç ka qenë më herët. Kërkesë kam prej disa shoferëve të kamionëve të cilët bartin ciment në kompaninë “Sharrcem” që me ua mundësuar me pasur një parking në Han të Elezit për shkak se u bine me prituri pesë deri në gjashtë orë dhe ua kanë bërë parkingun fushë të pajtimit në Kaçanik.

Erbli Maliqi thekson:- kam disa ankesa nga disa prind të cilët fëmijët e tyre i ndjekin mësimet në shkollë në Ferizaj dhe në mungesë të transportit kërkojnë që transporti i cili bëhet për nxënësit e qytetit të Kaçanikut që është në ora shtatë e dhjetë të shtyhet në orën tetë pasi që mund të shfrytëzohet edhe nga këto nxënës.

Hisni Luri thekson:- për çështje të printerëve kemi një kompani të kontraktuar që është edhe në administratën e komunës dhe këtu vazhdimisht i kanë bërë servisimet dhe i kemi thirr për me i rregulluar edhe në shkolla por nuk vijnë dhe arsyetohen se kemi shumë punë të tjera por kanë premtuar se kemi me bërë zgjidhje por deri sa të rregullohen duhet t'i aktivizojmë printerët e vjetër. Çështja e kontratës kolektive si kolegji i drejtorive komunale që Ministria me SBASHK-un ta bëjë një rishqyrtimin e kontratës kolektive .

Mehmet Ballazhi thekson:- për çështjen e transportit kam diskutuar dhe kam pasur takim me nxënësit të cilët i ndjekin mësimet në Ferizaj. Takim kam pasur me kompaninë “Elita” sepse ishin dy apo tre operatorë dhe kanë mbetur me diskutuar ata bashkë që gjysë ore me pritur dhe jemi dakorduar me një far forme që me pritur por ende nuk kam ndonjë konfirmim prej kompanisë. Parkingu i kompanisë në fillim kur e kam marr mandatin është zhvendosur atje me një vendim të më hershëm , mirëpo ne kemi hulumtuar se ku me gjetur ndonjë vend por nuk ka dhe kompania “Sharrcem” nuk i pranon kamionët brenda rrethojës së kompanisë dhe nëse kanë ndonjë alternativë të mundshme me mundemi me ju bashkuar sepse edhe mu nuk më duket e logjikshme me shkuar te varrezat e dëshmorëve në Kaçanik dhe pastaj me ardhur.

Kryesuesi thekson:- shoferët e kamionëve të komunës sonë dëmtohen edhe me mjete financiare për shkak se duhet me shkuar në fushë të pajtimit dhe përsëri me ardhur në Han të Elezit. Kompania “Sharrcem” e ka një mundësi se parkingun e ka brenda kompanisë por duhet të jetë një vullnet i joni që me shtyjë këtë proces përpara dhe nuk do të thotë që të gjithë shoferët me i prur në Han të Elezit por të paktën shoferët e Hanit të Elezit.

Lindita Ballazhi thekson:- sa i përket të hyrave vetanake është e vërtetë që me ligjin e buxhetit të viti 2023 te neni nëntë ceket që të gjitha të hyrat komunale të cilat nuk do të shfrytëzohen do të barten në fondin e Kosovës por kjo ende nuk është aprovuar dhe shpresoj që mos të aprovohet sepse ne si komunë do të afektohem por edhe do komunë në këtë shtet për shkak se shumica e projekteve kapitale e kanë edhe fondin prej të hyrave vetanake po ashtu edhe kategoritë e tjera buxhetore . Për shpenzimin e të hyrave vetanake nuk kam informacion të saktë momentalisht sepse duhet prej sistemit.

Sherif Berisha thekson:- ende nuk e kam pranuar agjendën nga drejtoresha për buxhet e financa. Pasi shkresa është publike pre Ministrisë së Arsimit për psikologët dhe pedagogët ku kanë mbetur procedurat e shpalljes së konkursit për psikologë dhe pedagogë. Kërkesë kam prej ekzekutivit të komunës pasi kemi hyrë në sezonin e dimrit familjeve në nevojë me ju ndarë dru për ngrohje.

Kryesuesi thekson:- çështja e agjendës është mirë me u kërkuar sepse arsyeja që po e potencojë këtë çështje është se duke i parë ekzekutivin në përgjithësi, i merr automjetet për punë zyrtare , për punë private për çdo punë unë nuk e ka parë të arsyeshme sepse po keqpërdoren veturat zyrtare. Si kryesues i kuvendit që një vit qeverisje automjetin e komunës e kam shfrytëzuar vetëm dy herë dhe kam paraqitur shkresë në mënyrë që me ditur se ku kam qenë. Nëse është ligji i njëjtë dhe nëse punohet me ligjin e republikës së Kosovës dhe jo me të Bajram Currit është mirë me u praktikuar edhe për kryesuesin e kuvendit. Unë e kam kërkuar një veturë që me pasur në mënyrë që kur të më vyhet me shfrytëzuar dhe ndoshta më vyhet por kur kam kërkuar më është thënë se duhet të keni agjendë dhe nëse vlen agjenda për kryesuesin e kuvendit duhet të vlen edhe për ekzekutivin e komunës.

Lindita Ballazhi thekson:- drejtorja e financave shumicën e shkuarjes në Ministri të Financave apo në departamentet në Ministri përkatëse nuk janë me agjenda dhe ka raste që në baza ditore shkojmë në Ministri që për ta nuk kemi agjenda por ndodhë edhe nëpër komuna të tjera dhe organizime të ndryshme të trajnimeve që janë prej Ministrisë së Financave dhe nëpër komuna të tjera.

Xhevahir Dernjani thekson:- fillimisht kryetarë ju urojë për çmimin Evropianë për qeverisje të mirë në të gjitha fushat është qeverisur mirë. A janë kryer procedurat për lëndët djegëse për institucionet e Hanit të Elezit. Te QKMF-ja duhet të bëhet një pastrim gjeneral sepse është prioritet shëndeti.

Mehmet Ballazhi thekson:- gjithçka është e përcaktuar me ligj dhe rregullore të cilat janë miratuar në këtë kuvend qoftë më herët qoftë tash. Sa i përket shfrytëzimit të automjeteve është e lejueshme edhe shkuarja me automjete private në mungesë të automjeteve zyrtare. Gradualisht do ti qesim shpenzimet që janë shpenzuar më herët dhe mos publikimet e raporteve të shpenzimeve që janë shpenzuar më herët për derivate apo për darka zyrtare për shkak se këtu nuk janë publikuar . Çështja e shfrytëzimit të automjeteve dhe posedimit të automjeteve është e përcaktuar me ligj se kush mund ta shfrytëzojë dhe kush mund ta posedojë dhe nëse ne duam me bërë jashtë ligjit dhe rregulloreve un nuk pajtohem me atë dhe besoj që gjithë secili nuk ishte pajtuar , mirëpo përcaktohet se kush dhe si mund t'i shfrytëzojë të gjitha automjetet.

Kryesuesi thekson:- për çështje të automjeteve është mirë me pasur parasysh që ligji me vlejë për të gjithë njëjtë për punë private dhe personale besoj që secili ka vetura të veta dhe ne ty kryejnë me vetura të vetat. Nëse i kërkohet kryesuesit agenda duhet të i kërkohet edhe drejtorit.

Refet Kalisi thekson:- është mirë me ja lënë një veturë edhe kryesuesit të kuvendit pasi që i ka edhe anëtarët e kuvendit të komunës.

Kryesuesi thekson:- asnjë herë dhe asnjë moment që e kam kërkuar veturën nuk mu është refuzuar dhe nuk mu ka vonuar dhe nuk është problem.

Hisni Luri thekson:- momentalisht e kemi një pedagog në vend të psikologut por tash është mirë se kemi edhe një psikologë që po funksionon në kuadër të gjitha shkollave. Hapësirat e lira të cilat i kemi pasur në arsim me udhëzimet e reja është kërkuar që të zihet tavani për shkak se pushimet e lehonisë i paguan Ministria dhe vendet e lira i kemi planifikuar për vitin 2023 që ti kemi edhe dy psikologë të tjerë nëpër shkolla. Sa i përket lëndës djegëse nëpër shkolla sipas informatave që i kam prej drejtorëve kanë potencuar se kurrë më mirë nuk ka qenë.

Hyriete Isufi thekson:- kërkoj sqarim se qfarë është bërë me konkursi e fizikës.

Hisni Luri thekson:- është rishpallur përsëri për shkak se me udhëzime të reja duhet të jenë së paku tre kandidatë për me i plotësuar kriteret për me hyjë në listën e ngushtë. Ky problem është në tërë Kosovën për Gjuhë Gjermane dhe për Fizikë.

Kryesuesi thekson:- a e zëvendëson dikush atë profesorë për punën e nxënësve dhe a ka pasur raste të tjera sikur ky i fizikës apo vetëm ky rast ka qenë që ju ka shpallur vendi i lirë i punës.

Hisni Luri thekson:- rastin e kemi edhe me gjuhën Gjermane që duhet të ndërmerret me konsulentë të jashtëm dhe po e shqyrtojmë edhe një mundësi të fundit për me rekrutuar një profesionistë dhe për deri sa në anë tjetër na bëhet presion për me ngritur cilësinë e vetmja mundësi për me ngritur cilësinë është me rekrutuar një profesionistë dhe në mungesë të kësaj duhet ta gjejmë një zëvendësim sepse shkon viti pa e pasur lëndën e fizikës. Numri total i nxënësve së bashku me të çerdhes është 1763.

Sherif Berisha thekson:- a figuron ende në listë të pagave profesori.


Hisni Luri thekson:-në listë të pagave nuk figuron por ka qenë një far keqkuptimi se për deri sa e kemi hapur pozitën e tij kemi marr një vendim dhe me atë vendim duhet të largohet nga lista pagave për shkak të grevave të cilët janë mbajtur Ministria e Financave nuk e ka larguar nga lista e pagave.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:33

Procesmbajtësi
Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

